



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1592/2 prot

Datë 18.06.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK  
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË  
TJERË**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-01574-04-16-2024, me objekt Lot 1 “*Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips*”, me fond limit 23,108,800 (*njëzet e tre milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkoder.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*MSE*” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “*Health & Light*” SHPK me NIPT L42231011L, me adresa: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 11, H. 4, Ap. 4, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Rajonal Shkoder.  
Adresa: Rruga “Kole Heqimi”, Shkodër.

**Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “*MSE*” SHPK me NIPT L61608005C, me Adresa: Rruga “Diga e Liqenit”, Nr. Pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270, Tiranë.

Në datën 14.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 1592/2024, datë 14.06.2024 dhe numër elektronik A/2024/4219, datë 14.06.2024, e operatorit ekonomik “*Health & Light*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-01574-04-16-2024, me

objekt Lot 1 “Mirëmbajtja “full risk” e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips”, me fond limit 23,108,800 (njëzet e tre milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkoder.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK kundërshton me anë të ankesës si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*Data e deklaratave (pika 2.3.3, 2.3.4, 2.3.7) të DST-se nuk është data e zhvillimit të procedurës (07.05.2024)*

*Deklarata (pika 2.3.7 e DST-se) jo e plote.*

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik “Health & Light” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “MSE” SHPK si më poshtë vijon:

#### **Shtojcën 5, Shtojcën 8/2, Kriteret të Veçanta të Kualifikimit, pika 1.a, pikën 2.3.2**

#### **Shtojca 5 Formulari i Specifikimeve Teknike**

Shërbimet që duhet të ofrohen: ***Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjeve mjekësore që janë në përdorim në disa spitale të vendit sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.***

Shërbimet që duhet të ofrohen:

**Mirëmbajtja parandaluese:** ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar

cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.

**Mirëmbajtja korigjuese:** Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

**Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse.**

**Shtojcën 8/2, Kriteria të Veçanta të Kualifikimit, pika 1.a, pikën 2.3.2**

**2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të njëjta për të gjitha lotet**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 9*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1(nje) inxhinier te trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit me profil inxhinier biomjekësor/elektronik/elektrik/mekatronik/IT.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për inxhinierin e mësipërm:

- Diploma
- Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore(formularet E-sig 025 ) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit per inxhinierat bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 18.06.2024

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**